

*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së
Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve
Dt.30.03.2021*

**30.03.2021
Ora 12:30**

RENDI I DITËS

Projektvendimi "Për shqyrtimin e kërkesës ankimore nr.7, me objekt "Kundërshtim i vendimit nr.172, dt.23.03.2021 të Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve "Për caktimin e sasisë së fondit nga Buxheti i Shtetit, që do t'u shpërndahen si paradhënie partive politike pjesëmarrëse në zgjedhjet për Kuvendin e Shqipërisë, të datës 25 prill 2021" subjekti ankues Koalicioni ABEOK".

PJESËMARRJA :

- **KAS:** Z.Elvin LAKO, Z.Elvis ÇEFA, Z.Ilirjan RUSMALI,
Z.Koli BELE, Z.Ledio BRAHO
- **Stafi KQZ:** Y.Merkaj
- **Koalicioni:** ABEOK (Z.Shpetim Kodhelaj)

Z. L.Braho: Atëherë, sot më datë 30 mars 2021 çelet seanca publike e shqyrtimit administrativ të kërkesës ankimore nr.7, të datës 25.03.2021, të paraqitur nga koalicioni me germa nistore ABEOK. Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve me vendimin nr.172, datë 23 mars 2021 në mbështetje të neneve 19, paragrafi 1, shkronja "k" e "n", paragrafi 2, të neneve 86, 88 dhe 180 të Kodit Zgjedhor ka vendosur të shpërndajë si paradhënie fondet e vëna në dispozicion nga Buxheti i Shtetit, partia politike pjesëmarrëse në zgjedhjet për Kuvendin e Shqipërisë të datës 25 prill 2021 sipas lidhjes 1, bashkëlidhur vendimit. Sipas vendimit të Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve, objekti i këtij ankimimi administrativ, nuk rezulton që partitë politike, pjesë e Koalicionit ABEOK, të jenë pjesë e partive

*Zbardhi materialin audio
Lorena KONJA*



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së
Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve
Dt.30.03.2021*

politike që kanë konkuruar në zgjedhjet vendore të vitit 2015 apo vitit 2019, si dhe ato të përgjithshmet të vitit 2017, dhe të kenë marrë një numër votash prej të paktën 1% në rang kombëtar. Ndaj këtij vendimi në zbatim të nenit 124 të Kodit Zgjedhor, ka paraqitur ankim Koalicioni ABEOK, i cili në respektim të kriterëve të përcaktuara në nenin 127, të Kodit Zgjedhor është regjistruar në regjistrin e ankimimeve zgjedhore me numër 7, datë 25.03.2021. Në seancën e datës 29 mars 2021, e cila ishte seancë e verifikimit paraprak, KAS vendosi pranimin për shqyrtim të kësaj kërkesë ankimore, të paraqitur nga Koalicioni ABEOK. Përveç ankimuesit ka ndonjë palë tjetër të interesuar që të ketë depozituar kërkesë si subjekt i interesuar, në zbatim të nenit 133, të Kodit Zgjedhor?

Z.Y.Merkaj: Jo, nuk ka!

Z. L.Braho: Atëherë, në lidhje me ankimuesin në qoftë se mund të prezantoheni, se dje ishin dy përfaqësues të tjerë.

Z. Sh.Kodhelaj, përfaqësues i Koalicionit ABEOK: Faleminderit zoti kryetar! Ne kemi paraqitur një ankim kundër vendimit të datës 23, në lidhje me fondin e Buxhetit të Shtetit për administrimin e subjekteve politike.

Z. L.Braho: Ju lutem, prezantohuni njëherë, se dje nuk keni qenë ju.

Z. Sh.Kodhelaj, përfaqësues i Koalicionit ABEOK: Shpëtim Kodhelaj, përfaqësues i Koalicionit ABEOK, në bazë të shkresës që kemi.

*Zbardhi materialin audio
Lorena KONJA*



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së
Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve
Dt.30.03.2021*

Z. L.Braho: Keni ndonjë kundërshtim ju, ose anëtarët e KAS-it në lidhje me elementë të konflikt të interesit apo të kësaj natyre për anëtarët?

Z. Sh.Kodhelaj, përfaqësues i Koalicionit ABEOK: Në lidhje me procedurën që ka kryer Komisioneri Shtetëror, fillimisht kur më janë prezantuar aktet ..

Z. L.Braho: Po pyes për gjë tjetër!

Z. Sh.Kodhelaj, përfaqësues i Koalicionit ABEOK: Jo, nuk kemi gjë!

Z. L.Braho: Nuk keni gjë. Në rregull, atëherë, mund të paraqesësh pretendimet dhe provat në lidhje me ankimet.

Z. Sh.Kodhelaj, përfaqësues i Koalicionit ABEOK: Kemi shpjegime dhe kërkesat tona në lidhje me këto pretendime, të cilat i kemi në 3 fletë. Fillimisht ne kundërshtojmë vendimin e Komisionerit si dhe projektvendimin për caktimin e sasisë së fondit nga Buxheti i Shtetit që do t'u shpërndahen si paradhënie partive politike pjesëmarrëse, në zgjedhjet për Kuvendin e Republikës të Shqipërisë. Nga Komisioneri Shtetëror nuk janë marrë parasysh, vendimi i KQZ-së, me numër 555, datë 26.07.2017, vendim i cili ka shpallur rezultatet në Kuvendin e datës 25 qershor 2017. Shuma që përfiton secila parti sipas nenit 19, pika 2, gërma "a" të ligjit 8580, datë 17.02.2000 për partitë politike i ndryshuar, përcaktuar në një mënyrë që shuma prej 98 milionë lekësh, e cila përbën 70% të shumës totale për t'u shpërndarë prej 140 milionë lekesh të reja i shtohet dhe shuma 345.800 lekë, e cila ngelet pa u shpërndarë nga 10 përqindëshi i shumës. Total, arrin në 98 milionë lekë e 345 mijë e 800, përpjesëtohet me numrin e deputetëve të Parlamentit

**Zbardhi materialin audio
Lorena KONJA**



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së
Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve
Dt.30.03.2021*

Shqiptar, që i thonë 140 deputetë, rezultati për çdo mandat i bie, përafërsisht 702 mijë e 470 lekë. Në rastin konkret theksojmë se, në rastin konkret ne kemi 4 deputetë që janë me mandat, që është Koalicioni ABEOK. Subjektet zgjedhore përfitojnë financim, Ligji 10019, 29.12.2008, Kodi Zgjedhor të Shqipërisë, nenit 87, shpërndarje dhe rishpërndarje e fondeve publike për subjektet zgjedhore. Subjekti zgjedhor përfiton financime nga fondet publike sipas rregullave të përcaktuara në këtë kod. Sasia e fondeve publike që do t'u shpërndahen subjekteve zgjedhore caktohen me vendim të Kuvendit së bashku me buxhetin e zgjedhjeve sipas nenit 86 të këtij Kodi. 2. Sasia e fondeve publike që i shpërndahet secilit subjekt zgjedhor caktohet me vendim të KQZ-së sipas rregullave të mëposhtme, 50% e shumës ndahet ndërmjet partive politike të regjistruara si subjekte zgjedhore që kanë mandate në Kuvend, e përcaktuar kjo sipas vendimit të KQZ-së për shpalljen e rezultatit përfundimtar të zgjedhjeve pararendëse. Kjo shumë u jepet këtyre partive politike nga KQZ-ja, jo më vonë se pas 5 ditësh, pas regjistrimit të tyre si subjekt zgjedhor dhe paraqitjen e listës shumëemërore për çdo zonë zgjedhore. Shuma shpërndahet mbi bazën e numrit të mandateve të fituara në zgjedhjet e Kuvendit, 50% të shumës të përgjithshme ndahet midis partive. Nga Komisioni Shtetëror siç e përmendëm edhe më sipër, kemi vendimin e KQZ-së me numrin 555, datë 26.07.2017, vendim i cili ka shpallur zgjedhjet e Kuvendit të datës 25 qershor 2017. Theksojmë se në rastin konkret ne kemi 4 deputetë, me mandat që kanë qenë pjesë e listës së partisë politike PD. Partia Demokratike në shkurt të vitit 2019 dorëzoi mandatet e Kuvendit të zgjedhjeve qendrore të vitit 2017. Fakti që është përfitues nga fondi i Buxhetit të Shtetit të zgjedhjeve më 25 prill 2021 është dhe subjekti Bindja Demokratike. Pra, duhet të shihet ky precedent. Një rast që është si ne, pretendimi që është i ngjashëm, mosdhënia e financimit nga fondi i buxhetit shtetëror, Koalicioni ABEOK është diskriminuar

*Zbardhi materialin audio
Lorena KONJA*



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së
Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve
Dt.30.03.2021*

dhe është bërë në mënyrë selektive trajtimi i fondeve përfituese. Komisioneri Shtetëror Zgjedhor na ka përjashtuar në mënyrë të padrejtë, duke shkelur Kodin Zgjedhor. Fakte, Partia Kombëtare Konservatore Albania, kryetar, deputet, zoti Kujtim Gjuzi. Partia Ora e Shqipërisë, kryetar, deputet, zoti Zef Shtjefni, Partia Emigracioni Shqiptar, kryetar, deputet, zoti Kostaq Papa, Partia Bashkimi Popullor i Pensionistëve të Shqipërisë, kryetar, deputet, zoti Selami Jenishehri. Këto parti politike janë me mandat në Kuvendin e Republikës së Shqipërisë që do të thotë mandati për llogaritje përkatëse i bie 702 mijë e 470 lekë, shuma që partia për çdo deputet që ka në parlament. Projektvendimi për caktimin e sasisë të fondit nga Buxheti i Shtetit që do t'u shpërndahen si paradhënie partive politike pjesëmarrëse të zgjedhjeve për Kuvendin e Shqipërisë, të datës 25 prill 2021, duhet të ndryshohet duke përfshirë Koalicionin ABEOK dhe të financohet nga Buxheti i Shtetit, bazuar në nenin 121, paragrafi "b" 124, 1 të Kodit Zgjedhor të Republikës së Shqipërisë, si dhe vendimi 555, datë 26.07.2017 i KQZ dhe ligjit 80, datë 17.02.2000, i ndryshuar për partitë politike siç e përmenda përkatësisht neni 19, pika 2, gërma "a" dhe "b" i ligjit. Vendimi i KQZ-së numër 555, datë 26.07.2017, i cili ka shpallur rezultatet për zgjedhjet e Kuvendit të datës 25 qershor 2017. Nisur sa më sipër kërkojmë pranimin e kërkesës ankimore kundër vendimit 172, datë 23.03.2021 të KQZ-së, detyrimin e KQZ-së, Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve të financojë Koalicionin ABEOK, bazuar bazës ligjore që kam përmendur më sipër, faleminderit!

Z. L.Braho: Faleminderit! Ndonjë pyetje nga anëtarët?

Z.I.Rusmali: Një pyetje kam për administratën në qoftë se është e mundur? Ankuesi bën një paralelizëm në pretendimet e veta me Partinë Bindja

*Zbardhi materialin audio
Lorena KONJA*



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së
Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve
Dt.30.03.2021*

Demokratike, e cila ka përfituar fonde ndërkohë që ankuesi në vlerësimin e tij në një situatë analoge nuk përfiton fonde. Ju e shihni analogjinë apo i dalloni nga njëra-tjetra dy subjektet?

Z.Y.Merkaj: Neni 88 i Kodit Zgjedhor përcakton se partitë pjesëmarrëse në zgjedhje që kanë marrë jo më pak se 1% të votave, mendoj që asnjë nga partitë e koalicionit që pretendon kërkuesi nuk ka marrë mbi 1% të votave në tre zgjedhjet e pararendëse, 2015, 2017, 2019. Duke qenë se nuk ka marrë 1% të votave, që është dhe kushti kryesor mendoj që nuk ka paralelizëm.

Z. L.Braho: Pyetje tjetër? Për këtë pyetjen në lidhje me Bindjen Demokratike është neni 180 i Kodit Zgjedhor që i jep përgjigje, që për partitë që nuk kanë garuar në zgjedhjet 2015-tës dhe 2017-tës shërben për përlogaritje të zgjedhjeve vijuese për zgjedhjet e 2019-ës, dhe kam përshtypjen ky duhet të jetë argumenti, sepse Bindja Demokratike përfshihet në partitë. Tani kam një pyetje! Ju, këtë ankimim e bëni në lidhje me buxhetin që ju takon për financimin e fushatës elektorale apo me buxhetin që ju takon sipas ligjit partive politike që ka lidhje me mbarëvajtjen e partisë, që është buxhet ose më saktë që është fond që jepet vit për vit, me vendim të KQZ-së?

Z. Sh.Kodhelaj, përfaqësues i Koalicionit ABEOK: Në lidhje me këtë përgjigje, ky është një fond që e ka caktuar nga Buxheti i Shtetit Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve që na takon, pra faktet u përmendën. Bindja Demokratike ka qenë pjesë e listës së Partisë Demokratike dhe tani është regjistruar, si ka dhe mandat që e përfaqëson zoti Murrizi, nuk është ajo që ngriti pretendim Komisioneri, si dhe për këto fakte unë do t'i kisha përmendur dhe më përpara, kur na u dha

*Zbardhi materialin audio
Lorena KONJA*



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së
Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve
Dt.30.03.2021*

projektvendimi, sepse mua nuk më janë komunikuar të gjitha aktet siç duheshin. Më kanë ardhur 10 minuta përpara dhe nuk isha njohur se këtë në shqyrtimin e projektvendimit do ta kisha argumentuar me fakte zoti Kryetar. Pra, ne na takon me ligj sepse ligji i auditimit, këto fonde duhet t'i shkarkojë. Lind pyetja, ku vajtën këto fonde që i takojnë kësaj partie, për shkak të mandateve që i bëra një përlllogaritje më përpara? Faleminderit!

Z. L.Braho: Një pyetje tjetër! Mandatet e deputetëve që 4 kryetarët e partive që janë pjesë e këtij koalicioni i kanë përfituar në zgjedhje, nën logon e këtyre partive apo në logon e ndonjë partie tjetër?

Z. Sh.Kodhelaj, përfaqësues i Koalicionit ABEOK: Kjo ka ardhur si pasojë e largimit të deputetëve të opozitës dhe këta kanë qenë automatikisht, përfitues të mandatit dhe nuk kemi ndonjë dispozitë ligjore që të marrë raste të tilla, precedent si ky, që ka ndodhur. Unë mendoj, me ligj ne na takon, faleminderit!

Z. L.Braho: Nuk e vë në dyshim pjesën që ju mendoni që ju takon se kjo është arsyeja që i jeni drejtuar dhe KAS-it me ankim, por në rezultatet zgjedhore të vitit 2015, 2017 dhe 2019 a ka qenë ndonjë nga këto parti që ka garuar dhe që ka marrë më shumë se 1% të votave në rang kombëtar, qofshin këto zgjedhje lokale apo të përgjithshme?

Z. Sh.Kodhelaj, përfaqësues i Koalicionit ABEOK: Në lidhje me zgjedhjet vendore të 30 qershorit 2019, Partia Konservatore Kombëtare Albania ka qenë në garë, por pasi kemi plotësuar dokumentacionin, njoftimin ia kanë bërë kryetarit nëpërmjet email-it që ai nuk ka pasur mundësi dhe ne e kemi apeluar në Kolegjin

*Zbardhi materialin audio
Lorena KONJA*



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së
Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve
Dt.30.03.2021*

Zgjedhor Gjyqësor Civil të Apelit. Njëkohësisht kemi parashtruar dhe kërkesën në Gjykatën Kushtetuese që këto zgjedhje kanë qenë antikushtetuese, sepse kemi dy momente, dekretim dhe çdekretim, i cili këtë tagër e ka vetëm institucioni i Presidentit. KQZ-ja, në mënyrën e saj, nuk i mori parasysh këto dy dekrete. Kemi qenë pjesë, faleminderit!

Z. L.Braho: Faleminderit! Ka ndonjë pyetje tjetër?

Z.I.Rusmali: Kam një pyetje unë. Më fal, ti e menaxhon vetë përgjigjen tënde por, keni marrë pjesë në zgjedhjet e fundit lokale dhe mund të na thoni cili është rezultati i tyre?

Z. Sh.Kodhelaj, përfaqësues i Koalicionit ABEOK: Ne kemi qenë, kemi përgatitur gjithë dokumentet, na ka përjashtuar KQZ-ja për faktin se nuk kishim marrë njoftimin për plotësim dokumentash.

Z.I.Rusmali: Nuk keni marrë pjesë!

Z. Sh.Kodhelaj, përfaqësues i Koalicionit ABEOK: Kemi depozituar gjithë dokumentet, por u përjashtuam nga KQZ-ja.

Z.I.Rusmali: Në qoftë se jeni i përjashtuar do të thotë, nuk keni marrë pjesë në garë dhe nuk keni një rezultat.

Z. Sh.Kodhelaj, përfaqësues i Koalicionit ABEOK: Nuk morëm pjesë për shkak të njoftimeve. Nuk kemi rezultat.

**Zbardhi materialin audio
Lorena KONJA**



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së
Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve
Dt.30.03.2021*

Z.I.Rusmali: Në 2017 siç thatë ju, kryetarët e partive tuaja kanë marrë pjesë si kandidatë të PD-së apo jo? Në listën e PD-së?

Z. Sh. Kodhelaj, përfaqësues i Koalicionit ABEOK: Po!

Z.I.Rusmali: Do të thotë subjektet, partitë, vetë nuk kanë rezultat, apo jo? Se kanë garuar brenda PD-së. Rezultatin e ka PD-ja dhe përfitimet i llogariten PD-së. Në 2015-ën keni marrë pjesë si subjekte dhe çfarë rezultati keni pasur?

Z. Sh.Kodhelaj, përfaqësues i Koalicionit ABEOK: Për 2015-ën nuk jam i informuar.

Z.I.Rusmali: Është në gjendje KQZ-ja të na japin shifrën, rezultatin e këtyre partive, a kanë marrë pjesë apo jo dhe çfarë rezultati kanë arritur nëse kanë marrë pjesë?

Z.Y.Merkaj: Për momentin nuk mund të jap përgjigje se kush është rezultati, por tek vendimi 172, që ankimon ankimuesi, është përcaktuar cilat janë partitë që kanë marrë mbi 1% të zgjedhjeve, në të gjitha zgjedhjet, në 2015, 2017 dhe 2019 dhe janë konkretisht 13 parti. Mund t'i lexoj në qoftë se doni. Janë për të tria zgjedhjet dhe nuk kemi rezultat. Kush ka marrë 1%, ne kemi llogaritur partitë, që kanë marrë mbi 1% të zgjedhjeve, në të tria zgjedhjet, 2015, 2017 dhe 2019. Me partitë që kanë marrë mbi 1% nuk rezulton asnjë nga këto katër partitë. Do të thotë që rezultati ka qenë nën 1% në zgjedhjet e 2015-tës.

**Zbardhi materialin audio
Lorena KONJA**



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së
Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve
Dt.30.03.2021*

Z.I.Rusmali: Një pyetje për ankuesin. Sipas vendimit për shpalljen e rezultatit përfundimtar të vitit 2015 rezulton që në zgjedhje ka marrë pjesë Partia Konservatore e cila është e ndryshme nga Partia Kombëtare Konservatore Albania, po apo jo?

Z. Sh.Kodhelaj, përfaqësues i Koalicionit ABEOK: Kanë shtuar siglën me sa di, kanë bërë një ndryshim me vendim gjykatë dhe nuk jam i qartë për këtë gjë.

Z.I.Rusmali: Në rregull! Mungon qartësia për këtë gjë, Partia Ora e Shqipërisë sipas rezultatit, sipas vendimit zyrtar për shpalljen e rezultatit ka marr pjesë, ka pas rezultat në 2015, 0.69%. Ju jeni në dijeni të këtij fakti?

Z. Sh. Kodhelaj, përfaqësues i Koalicionit ABEOK: Në lidhje me këto 3 subjektet e tjera që kanë bërë koalicion nuk kam dijeni. Unë kam dijeni vetëm në lidhje me Partinë Kombëtare Konservatore Albania.

Z.I.Rusmali: Në qoftë se na ndihmon administrata, unë nuk e shoh as subjektin Partia Bashkimi Popullor i Pensionistëve të Shqipërisë dhe as subjektin Partia Emigracioni Shqiptar në zgjedhjet e 2015-ës.

Z. L.Braho: Zgjedhjet e 2015-ës, vetëm këto dy parti janë që kanë marrë pjesë dhe janë pjesë e koalicionit. Pra, Ora e Shqipërisë dhe Partia Konservatore.

Z.I.Rusmali: E cila nuk dihet me siguri është e njëjta parti apo jo?

Z.L.Braho: Nuk dihet! Në 2017 nuk është asnjë nga partitë e koalicionit, ndërkohë që në 2019-ën është Partia Ora e Shqipërisë që ka marrë 0.44 % dhe Partia

*Zbardhi materialin audio
Lorena KONJA*



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së
Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve
Dt.30.03.2021*

Emigracioni Shqiptar që ka marrë 0.03%. Pra, në 2019 vetëm këto dy parti janë. Partitë e tjera nuk rezultojnë që të kenë garuar në zgjedhjet e 2019-tës.

Z. Sh.Kodhelaj, përfaqësues i Koalicionit ABEOK: Kisha një pyetje, në lidhje me subjektin Bindja Demokratike ka në zgjedhjet e 2017 ka qenë si..

Z.I.Rusmali: Po i bën pyetje KAS-it tani apo jo? Në rregull, ne e fiksuam Bindjen Demokratike, do ta shqyrtojmë me vëmendje analogjinë që bëni ju dhe ne do japim përgjigje për analogjinë që bëni ju me vendim!

Z.Sh.Kodhelaj, përfaqësues i Koalicionit ABEOK: Në rregull, faleminderit!

Z. L.Braho: Nga anëtarët e tjerë ka ndonjë pyetje? Mirë, atëherë, KAS do tërhiqet për vendim. Do ju njoftojmë për 20 minuta besoj. Keni ndonjë pretendim tjetër?

Z.Sh.Kodhelaj, përfaqësues i Koalicionit ABEOK: Janw ato qw parashtrova me shkrim.

Z. L.Braho: Me shkrim, mund t'i deponitosh tek administrata dhe i bëjmë pjesë të dosjes. Atëherë për 20 minuta do ju thërrasë administrata e KQZ-së për vendimin, faleminderit!

*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së
Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve
Dt.30.03.2021*

Rifillon seanca

Ora: 13:10

Z. L.Braho: Atëherë KAS pasi u tërhoq për vendim, në përfundim të shqyrtimit administrativ të ankimit kundër vendimit të Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve nr.172, datë 23.03.2021, bazuar në analizën e fakteve dhe provave të administruara, mbështetur në shkronjën “b” të pikës 1 të nenit 30 të vendimit nr. 3, datë 06.11.2020 të Komisionit Rregullator, vendosi:

- 1.Rrëzimin e Kërkesës Ankimore nr. 07, datë 25.03.2021 të subjektit zgjedhor koalicioni Aleanca Bashkimi Popullor Emigracioni - Ora e Shpresës dhe Konservatorët (ABEOK);
- 2.Lënien në fuqi të vendimit nr. 172, datë 23.03.2021 të Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve “Për përcaktimin e sasisë së fondit nga Buxheti i Shtetit që do t’u shpërndahet si paradhënie partive politike pjesëmarrëse në zgjedhjet për Kuvendin e Shqipërisë, të datës 25 prill 2021”;
- 3.Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe publikohet në faqen zyrtare të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve.
- 4.Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Kolegjin Zgjedhor pranë Gjykatës së Apelit Tiranë brenda 5 ditëve nga hyrja e tij në fuqi.

Vendimi nr.13

*Zbardhi materialin audio
Lorena KONJA*

